



RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

MIRATIMIN E KARAKTERISTIKAVE THEMELORE TË FUNKSIONALITETIT TË PLATFORMËS ELEKTRONIKE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, “e”, “ë”, të ligjit nr. 10019, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projekta me karakter normativ të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, mbi llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit, që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë, për rregullat për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, të domosdoshme për të siguruar përdorimin e ligjshëm, të rregullt, transparent, efikas dhe të qëndrueshëm të tyre.

Neni 25, pika 5 e Kodit Zgjedhor parashikon se zgjedhësi që dëshiron të votojë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pas hapjes së procesit të regjistrimit nga KQZ-ja aplikon në mënyrë individuale për regjistrim në listën e këtyre zgjedhësve. KQZja krijon, mirëmban dhe përditëson platformën elektronike për regjistrimin e kërkesave të zgjedhësve që dëshirojnë të votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar në mbështetje të ndryshimeve më të fundit të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim krijimin, administrimin, funksionimin, mirëmbajtjen, mbikëqyrjen dhe auditimin e platformës elektronike për regjistrimin e kërkesave të zgjedhësve nga jashtë vendit, nga këtu e në vijim referuar në vendim si “PER”.

Në kreun I të projektvendimit parashikohen rregulla të përgjithshme të përcaktuara në Ligj sa i takon shfaqjes së vullnetit të zgjedhësve nga jashtë vendit për t'u regjistruar në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit, me qëllim ushtrimin e të drejtës së votës për zgjedhjet për Kuvend, ku përcaktohet se zgjedhësi që dëshiron të votojë nga jashtë paraqet një kërkesë në mënyrë individuale për regjistrim në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit përmes Platformës Elektronike të Regjistrimit. Rregullat për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit janë ato të përcaktuara në aktin përkatës të Komisionit Rregullator.

Në kreun II parashikohen rregullat që lidhen me krijimin, administrimin, dhe funksionimin e PER, si dhe rregullat teknike për shqyrtimin e kërkesave për regjistrim nga PER.

Platforma Elektronike e Regjistrimit krijohet, mirëmbahet dhe përditësohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. PER është një platformë që gjendet dhe mund të përdoret në të dy versionet, si në versionin desktop, ashtu edhe në atë mobile, pa qenë i kushtëzuar nga lloji i pajisjes që do të përdorë zgjedhësi, për të rritur aksesueshmërinë për t'u përdorur nga të gjithë.

Në zbatim të kuadrit rregullator në fuqi "Për mbrojtjen e të dhënave personale", përcaktohet se të gjitha të dhënat e regjistruara duhet të mbeten në pajisjet e përdoruesve dhe në një qendër të dhënash të menaxhuar nga KQZ, dhe po në përputhshmëri me këtë kuadër ligjor duhet të krijohet dhe të funksionojë PER.

PER do të ketë dy (2) komponentë/ module kryesore, të cilat do të mundësojnë një proces të sigurtë dhe të besueshëm për menaxhimin e kërkesave për regjistrim:

- a) **Moduli i regjistrimit**, përmes së cilës zgjedhësi bën kërkesën për regjistrim dhe verifikon identitetin;
- b) **Moduli i shqyrtimit të kërkesave**, përmes së cilës KQZ shqyrton dhe verifikon informacionin e paraqitur nga zgjedhësit.

Për funksionalitetin e PER, kjo platformë duhet të plotësojë minimalisht kërkesat teknike si më poshtë vijon:

- a. Mbledhje e të dhënave të gjeneralitetit, biometrike dhe atyre të dokumenteve fizike të skanuar që zgjedhësi plotëson dhe/ose ngarkon në PER.
- b. Të jetë në gjendje të kap një foto "selfie" të zgjedhësit për ta ruajtur në sistemin qendror të menaxhimit të identitetit. Për të siguruar cilësinë e 'selfie-t', aplikacioni në internet dhe aplikacioni i portofolit digjital duhet të lehtësojnë dhe optimizojnë procesin e kapjes së fotos.
- c. Të kryejë kontrollin e verifikimit të pranisë së gjalli të personit (ang. *user liveness check*) dhe të krahasojë fotografinë e marrë me fotografinë e profilit të siguruar nga një ID fizike e vërtetuar.
- d. Të lexojë automatikisht të dhënat identifikuese nga dokumenti i identifikimit të zgjedhësit.
- e. Sistemi duhet të ketë aftësinë të vërtetojë dokumentin fizik të identifikimit duke verifikuar karakteristikat e dokumentit, si fotot, shpërndarjen e informacionit, strukturën,

- regjistrimet, kodet dy dimensionale dhe nënshkrimet e të dhënave për dokumentet e bazuara në NFC, ndër të tjera.
- f. Të përfshijë një motor njohje që ndihmon zgjedhësin të pozicionojë saktë dokumentin e identifikimit brenda një kornize, të rregullojë imazhin për të siguruar këndin dhe cilësinë e kërkuar, dhe të kapë automatikisht imazhin e dokumentit.
 - g. Të lejojë nxjerrjen automatike të informacionit nga dokumenti fizik i identifikimit dhe leximin e kodeve dy dimensionale të barrave për të krahasuar informacionin e koduar me të dhënat e printuara.
 - h. Nxjerrja e informacionit nga dokumentet fizike të identifikimit duhet të bëhet përmes Njohjes Optike të Karaktereve (ang. OCR).
 - i. Sistemi duhet të kërkojë adresën e emailit të zgjedhësit ose numrin celular dhe të përdorë një fjalëkalim një herë për të konfirmuar informacionin e kontaktit të dhënë nga zgjedhësi;
 - j. Sistemi duhet të kërkojë adresën e plotë të zgjedhësit jashtë vendit sipas fushave të paracaktuara në aktin përkatës të Komisionit Rregullator.
 - k. Sistemi duhet të lejojë ngarkimin e një dokumenti si provë të adresës. Verifikimi i adresës do të bëhet nga operatori/nëpunës KQZ nga Moduli i Shqyrtimit të Kërkesave.
 - l. Sistemi duhet të përfshijë gjeolokalizimin e zgjedhësit në momentin e aplikimit si pjesë e informacionit të kërkesës.
 - m. Portofoli digjital duhet të jetë në gjendje të skanojë dokumente me madhësi të ndryshme dhe t'i ruajë ato në profilin e zgjedhësit.
 - n. Të përdorë protokollin e Sigurisë së Shtresës së Transportit (TLS) 1.2 për të siguruar komunikimet me platformën qendrore të KQZ.
 - o. Të ketë mekanizëm të kontrollit të aksesit biometrik (njohje e fytyrës).
 - p. Mekanizëm për bllokimin e aksesit nëse bëhen disa përpjekje të pasuksesshme për hyrje.
 - q. Arkitektura e PER mund të përdorë një qasje cloud për përpunimin e të dhënave nëse të dhënat përpunohen në Shqipëri ose BE. Ruajtja e të dhënave të qytetarëve duhet të bëhet në datacenterin e KQZ të ndodhur në Shqipëri.
 - r. PER duhet të lejojë operatorët/stafin e KQZ të shqyrtojnë aplikimet e marra dhe të pranojnë, refuzojnë, ose të kërkojnë më shumë informacion.
 - s. Kur një aplikim refuzohet, operatori/stafi i KQZ duhet të japë një nga arsyet e paracaktuara për refuzimin dhe kjo duhet të komunikohet tek kërkuesi.
 - t. Kur një operator/stafi i KQZ zgjedh të kërkojë më shumë informacion, duhet të specifikohet qartë në mesazh se cili informacion shtesë duhet të sigurohet.
 - u. Zgjedhësi duhet të njoftohet për ndryshimet e statusit të aplikimit të tij.
 - v. Njoftimet do të dërgohen në adresën e email-it dhe/ose numrin celular të dhënë nga zgjedhësi gjatë procesit të aplikimit si dhe PER.
 - w. Kur një kërkesë për regjistrim është shqyrtuar dhe miratuar, PER do të dërgojë një njoftim që informon zgjedhësin për regjistrimin e suksesshëm.
 - x. Kur një kërkesë është shqyrtuar dhe refuzuar, sistemi do të dërgojë një njoftim duke informuar zgjedhësin për refuzimin dhe duke ofruar arsyen/et e refuzimit.
 - y. PER duhet të sigurojë një portal menaxhimi për të kontrolluar përdoruesit administrator;

- z. Për të aksesuar Modulin e Shqyrtimit të Kërkesave, zgjidhja duhet të lejojë autentifikimin me 2 (dy) faktorë përmes hyrjes me emër përdoruesi-fjalëkalim dhe kodit unik i përkohshëm 6 shifror që i dërgohet operatorit/staf i KQZ në numrin e tij të telefonit mobile dhe/ose email;
- aa. Moduli i Shqyrtimit të Kërkesave duhet të mbyllë sesionin e përdoruesit nëse nuk ka aktivitet për një periudhë të paracaktuar kohe;

Në projektakt përcaktohen rregullat teknike në lidhje me shqyrtimin e kërkesave për regjistrim nga PER. Pas kryerjes së aplikimit (kërkesës për aplikim) nga ana e zgjedhësit nga jashtë, PER kontrollon saktësinë dhe përputhshmërinë e të dhënave të identitetit të zgjedhësit, ato të cilat merren/gjenden në dokumentin e identifikimit., për të kontrolluar saktësinë e gjeneraliteteve të zgjedhësit me ato të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC). Shqyrtimin e kërkesave për regjistrim PER e realizon përmes 3 (tre) formave:

- a. Verifikimit automatik në kohë reale *me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC)*, kontrollon saktësinë dhe përputhshmërinë e të dhënave identifikuese të zgjedhësit.
- b. PER verifikon automatikisht përputhshmërinë e të dhënës biometrike të identifikimit të zgjedhësit nga jashtë vendit që paraqet kërkesën për regjistrim në PER *me foton e skanuar nga dokumenti i identifikimit që ai ngarkon në PER.*
- c. *Verifikohet nga përdoruesit e modulit të shqyrtimit të kërkesave nëse dokumentacioni i cili vërteton adresën e banimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është në përputhje me kërkesat e parashikuara në aktin përkatës të Komisionit Rregullator.*

Në kreun III përcaktohen rregullat në lidhje me mirëmbajtjen, mbikëqyrjen dhe auditimin e PER, ku parashikohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të parashikojë dhe hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit (*ang. Service Level Agreement – SLA*), që nënshkruhet ndërmjet KQZ dhe ofruesit të shërbimit të TIK me objekt mirëmbajtjen e PER. Kjo marrëveshje duhet të ketë një kohëzgjatje jo më të shkurtër se 2 (dy) vjet në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Për të siguruar transparencë dhe qasje të të gjitha palëve, iu njihet e drejta: partive politike, organizatave joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatave ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesve të shteteve të huaja të akredituara, si dhe të medias, të njihen me të gjitha elementët dhe karakteristikat teknike të PER, veçanërisht gjatë proceseve: të testimi paraprak operacional, kontrollit apo auditimit të saj, si dhe KQZ duhet t'i njoftojë në kohë për të marrë pjesë në këto këqyrje, dhe t'u vërë në dispozicion paraprakisht të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

KQZ, me kërkesë të partive politike, ose kryesisht, mundëson auditim të pavarur të PER nga subjekte të specializuara në çdo fazë, dhe për këtë qëllim KQZ duhet ta parashikojë në buxhetin e institucionit fondit përkatës.

Bashkëndimi i projektvendimit me palët e interesura

Ky projektvendim i është dërguar për mendim përfaqësuesve të partive politike, përfaqësuesve të organizatave të diasporës, organizatave të shoqërisë civile vendase të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, veprimtaria e të cilave ka në fokus zgjedhjet, si dhe medias.

Mendimi i vetëm i ardhur me shkrim ka qenë i zj. *Anila Smorgrav (Hyka)*, përfaqësuese e KKD (Këshilli Kombëtar i Diasporës) në opinionin e së cilës shprehet se: “ në nenin II.1: pika 2 të reflektohet si më poshtë vijon modulet:” të cilat duhet t plotsojn kriteret e "good development practices" sipas standardeve dhe certifikimeve internacionale. Tipi dhe detajet e standardeve duhet t përcaktohen n "requirement specifications" n procesin e prokurimit të aplikacionit" ; “neni II.2 pika j: mbi përcaktimin e fushave t adres: kujdes duhet br me fushat, q t mos jen t ngurta. Pasi adresat n vende t ndryshme nuk kan formate t njjta, t mbahet parasysh n specifikimet teknike gjat." Referuar piks ‘p’, mekanizmi i bllokimit:" mekanizmi i bllokimit t shoqrohet dhe me procedurn e ç’bllokimit."; pika ‘q’: ruajtja e t dhnave t prdoruesit n DC et KQ" pr arsye sigurie, sugjeron q t dhnat personale t ruhen n nj data center t ndar nga dukumentacionet shoqeruese t vrtetimit t adres ,pr t shmangur infektim virusesh q mund t vijn nga ndonj dokument pdf. dhe sistemi kur upload PDF, duhet t pajiset me mekanizm skanimi pr viruse" ...pika s & t mbi veprimtarin e stafit n sistemin e t dhnave:"kujdes me prfshirjen e stafit n futje t t dhnave t sistemit. Vet sistemi duhet t trajtoj automatikisht informacionin dhe prgjigjet - dhe t’i rezervoj pr prgjigje prdoruesit. Dhe kto t dhna t jen "read only" pr stafin e suportit. pika y: " Sugjerim riformulim: "PER duhet t jet i pajisur me nj modul t veçant t administration log control dhe nivele t ndryshme sigurie t aksesit n t dhna , q siguron tracking dhe identifikimin t çdo lvizje t stafit t administrimit t sistemit. Kjo minimalizon riskun e ndrhyrjeve ad-hoc dhe gabimeve njerzore."

N nenin II.3, pika 1 “C” verifikimi nga prdoruesi i modulit, duhet specifikuar me sakt se kush jan prdoruesit e modulit. Ns sht stafi, mir do t ishte q sistemi t jet i pajisur me kontrollin paraprak t prputhshmris. Sot me AI mund t skanosh nj dokument pdf, dhe t marresh prgjigjen pr pjesn e adres. Dhe nse prgjigja del e pasakt, dokumenti t vihet n nj kontenier t veçant pr verifikim manual nga stafi i ekspertve t autorizuar."

Në projektvendim janë reflektuar të gjitha komentet e ardhura.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin, “Për miratimin e karakteristikave themelore të funksionalitetit të platformës elektronike për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

Jona JOSIFI - Drejtorja e Votimit nga Jashtë

Pavlina Doçaj - Drejtorja e Ligjshmërisë (në mungesë dhe me urdhër)

Majlinda ÇELMETA – Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

**Ilirjan
Celibashi**



Digitally signed by Ilirjan Celibashi
Date: 2024.11.01 21:48:41 +02'00'



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më

protdate

Nr.

protnumber

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**MIRATIMIN E KARAKTERISTIKAVE THEMELORE TE FUNKSIONALITETIT
TË PLATFORMËS ELEKTRONIKE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA
JASHTË TERRITORIT NË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronjat “dh” “e” “ë”, nenit 25, pika 5 të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

I. Rregulla të përgjithshme

1. Zgjedhësi që dëshiron të votojë nga jashtë paraqet kërkesë në mënyrë individuale për regjistrim në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit përmes Platformës Elektronike të Regjistrimit, nga këtu e vijim në këtë vendim referuar si “PER” e cila krijohet, mirëmbahet dhe përditësohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për këtë qëllim.
2. Rregullat për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit janë ato të përcaktuara në aktin përkatës të Komisionit Rregullator.

II. Rregulla të posaçme për përcaktimin e karakteristikave themelore të funksionalitetit të PER

II.1. Rregullat për krijimin edhe administrimin e PER

Data: dd mmvvvv Nr: 000-000

Ora: hh:mm



Për miratimin e parimeve dhe karakteristikave të përgjithshme teknike për krijimin, funksionimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe auditimin e Platformës Elektronike të Regjistrimit (PER).

1. Për të rritur aksesueshmërinë, zgjedhësit do t'i jepet mundësia ta shkarkojë dhe përdorë PER si në versionin desktop, ashtu edhe në atë mobile pa qenë i kushtëzuar nga lloji i pajisjes elektronike që do të përdorë.
2. PER duhet të krijohet dhe të funksionojë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi që lidhet me ruajtjen e të dhënave personale të zgjedhësve. Të gjitha të dhënat duhet të mbeten në pajisjet e përdoruesve dhe në një qendër të dhënash të menaxhuar nga KQZ.
1. PER do të ketë dy komponente kryesore:
 - a. **Modulin e regjistrimit**, përmes së cilës zgjedhësi bën kërkesën për regjistrim dhe verifikon identitetin;
 - b. **Modulin e shqyrtimit të kërkesave**, përmes së cilës KQZ shqyrton dhe verifikon informacionin e paraqitur nga zgjedhësit.
2. Këto module do të plotësojnë kriteret ndërkombëtare të praktikave më të mira të zhvillimit (*ang. 'Good Development Practices'*).
3. Këto module do të mundësojnë një proces të sigurtë dhe të besueshëm për menaxhimin e kërkesave për regjistrim

II.2. Rregullat për funksionimin e PER

1. PER duhet të plotësojë minimalisht kërkesat teknike si më poshtë vijon:
 - a. Mbledhje e të dhënave të gjeneralitetit, biometrike dhe atyre të dokumenteve fizike të skanuar që zgjedhësi plotëson dhe/ose ngarkon në PER.
 - b. Të jetë në gjendje të kap një foto “selfie” të zgjedhësit për ta ruajtur në sistemin qendror të menaxhimit të identitetit. Për të siguruar cilësinë e ‘selfie-t’, aplikacioni në internet dhe aplikacioni i portofolit digjtal duhet të lehtësojnë dhe optimizojnë procesin e kapjes së fotos.
 - c. Të kryejë kontrollin e verifikimit të pranisë së gjalli të personit (*ang. user liveness check*) dhe të krahasojë fotografinë e marrë me fotografinë e profilit të siguruar nga një ID fizike e vërtetuar.
 - d. Të lexojë automatikisht të dhënat identifikuese nga dokumenti i identifikimit të zgjedhësit.
 - e. Sistemi duhet të ketë aftësinë të vërtetojë dokumentin fizik të identifikimit duke verifikuar karakteristikat e dokumentit, si fotot, shpërndarjen e informacionit, strukturën, regjistrimet, kodet dy dimensionale dhe nënshkrimet e të dhënave për dokumentet e bazuara në NFC, ndër të tjera.
 - f. Të përfshijë një motor njohje që ndihmon zgjedhësin të pozicionojë saktë dokumentin e identifikimit brenda një kornize, të rregullojë imazhin për të siguruar këndin dhe cilësinë e kërkuar, dhe të kapë automatikisht imazhin e dokumentit.
 - g. Të lejojë nxjerrjen automatike të informacionit nga dokumenti fizik i identifikimit dhe leximin e kodeve dy dimensionale të barrave për të krahasuar informacionin e koduar me të dhënat e printuara.
 - h. Nxjerrja e informacionit nga dokumentet fizike të identifikimit duhet të bëhet përmes Njohjes Optike të Karaktereve (*ang. OCR*).
 - i. Sistemi duhet të kërkojë adresën e emailit të zgjedhësit ose numrin celular dhe të përdorë një fjalëkalim një herë për të konfirmuar informacionin e kontaktit të dhënë nga zgjedhësi;
 - j. Sistemi duhet të kërkojë adresën e plotë të zgjedhësit jashtë vendit sipas fushave të paracaktuara në aktin përkatës të Komisionit Rregullator.

- k. Sistemi duhet të lejojë ngarkimin e një dokumenti si provë të adresës. Verifikimi i adresës do të bëhet nga operatori/nëpunës KQZ nga Moduli i Shqyrtimit të Kërkesave.
- l. Sistemi duhet të përfshijë gjeolokalizimin e zgjedhësit në momentin e aplikimit si pjesë e informacionit të kërkesës.
- m. Portofoli digjital duhet të jetë në gjendje të skanojë dokumente me madhësi të ndryshme dhe t'i ruajë ato në profilin e zgjedhësit.
- n. Të përdorë protokollin e Sigurisë së Shtresës së Transportit (TLS) 1.2 për të siguruar komunikimet me platformën qendrore të KQZ.
- o. Të ketë mekanizëm të kontrollit të aksesit biometrik (njohje e fytyrës).
- p. Mekanizëm për bllokimin e aksesit nëse bëhen disa përpjekje të pasuksesshme për hyrje.
- q. Mekanizëm për zhblokimin e aksesit në rastet e bllokimit.
- r. Arkitektura e PER mund të përdorë një qasje cloud për përpunimin e të dhënave nëse të dhënat përpunohen në Shqipëri ose BE. Ruajtja e të dhënave personale të zgjedhësve duhet të bëhet në një ambient fizik apo virtual ruajtjeje i ndarë nga ambienti ku do të ruhen dokumentacionet shoqeruese të vertetimit të adresës.
- s. PER duhet të lejojë operatorët/stafin e KQZ të shqyrtojnë aplikimet e marra dhe të pranojnë, refuzojnë, ose të kërkojnë më shumë informacion.
- t. Kur një aplikim refuzohet, operatori/stafi i KQZ duhet të japë një nga arsyet e paracaktuara për refuzimin dhe kjo duhet të komunikohet tek kërkuesi.
- u. Kur një operator/stafi i KQZ zgjedh të kërkojë më shumë informacion, duhet të specifikohet qartë në mesazh se cili informacion shtesë duhet të sigurohet.
- v. Zgjedhësi duhet të njoftohet për ndryshimet e statusit të aplikimit të tij.
- w. Njoftimet do të dërgohen në adresën e email-it dhe/ose numrin celular të dhënë nga zgjedhësi gjatë procesit të aplikimit si dhe PER.
- x. Kur një kërkesë për regjistrim është shqyrtuar dhe miratuar, PER do të dërgojë një njoftim që informon zgjedhësin për regjistrimin e suksesshëm.
- y. Kur një kërkesë është shqyrtuar dhe refuzuar, sistemi do të dërgojë një njoftim duke informuar zgjedhësin për refuzimin dhe duke ofruar arsyen/et e refuzimit.
- z. PER duhet të jetë i pajisur me një modul të veçantë kontrollit për historikun e veprimeve të administrimit dhe nivele të ndryshme sigurie të aksesit në të dhëna, që siguron gjurmimin dhe identifikimin e çdo veprimi të stafit që administron sistemin. Kjo minimalizon riskun e ndërhyrjeve të papritura dhe gabimeve njerzore.
- aa. Për të aksesuar Modulin e Shqyrtimit të Kërkesave, zgjidhja duhet të lejojë autentifikimin me 2 (dy) faktorë përmes hyrjes me emër përdoruesi-fjalëkalim dhe kodit unik i përkohshëm 6 shifror që i dërgohet operatorit/staf i KQZ në numrin e tij të telefonit mobile dhe/ose email;
- bb. Moduli i Shqyrtimit të Kërkesave duhet të mbyllë sesionin e përdoruesit nëse nuk ka aktivitet për një periudhë të paracaktuar kohe;

II.3. Rregullat teknike për shqyrtimin e kërkesave për regjistrim nga PER

- 1. Shqyrtimi i kërkesave dhe regjistrimi i zgjedhësve nga jashtë vendit në PER kryhet përmes:
 - a. Verifikimit automatik në kohë reale me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC), kontrollon saktësinë dhe përputhshmërinë e të dhënave identifikuese të zgjedhësit.

- b. PER verifikon automatikisht përputhshmërinë e të dhënës biometrike të identifikimit të zgjedhësit nga jashtë vendit që paraqet kërkesën për regjistrim në PER me foton e skanuar nga dokumenti i identifikimit që ai ngarkon në PER.
- c. PER verifikon dokumentacionin i cili vërteton adresën e banimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- d. Verifikohet manualisht nga stafi i autorizuar nga KQZ në Modulin e Shqyrtimit të Kërkesave nëse dokumentacioni i cili vërteton adresën e banimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është në përputhje me kërkesat e parashikuara në aktin përkatës të Komisionit Rregullator.

III. Rregullat për mirëmbajtjen, mbikqyrjen dhe auditimin e PER

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të parashikojë dhe të hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit (ang. *Service Level Agreement - SLA*). Kjo marrëveshje, nënshkruhet ndërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ofruesit të shërbimit të TIK me objekt mirëmbajtjen e PER. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë jo më e shkurtër se 2 (dy) vjet në zbatim të legjislacionit në fuqi.
2. Partitë politike, organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja të akredituar në Shqipëri, si dhe të medias, të cilat kanë të drejtë të njihen me të gjitha elementët dhe karakteristikat teknike të PER, veçanërisht gjatë proceseve të: testimit paraprak operacional, kontrollit apo auditimit të saj do të duhet të njoftohen në kohë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të marrë pjesë në këto qqyrje si dhe do duhet tu vërë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm paraprakisht.
3. Me kërkesë të partive politike, ose kryesisht, KQZ mundëson auditim të pavarur të PER nga subjekte të specializuara në çdo fazë. Për të mundësuar këtë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr masa të parashikojë në buxhetin e institucionit fondin përkatës për këtë qëllim.

IV. Dispozita të fundit

1. Ngarkohet administrata e KQZ dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim, me zbatimin e tij.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda (5) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

**Ilirjan
Celibashi**

Digitally signed by Ilirjan Celibashi
Date: 2024.11.01 21:50:48 +02'00'



Data: dd mmvvvv Nr: 000-000

Ora: hh:mm



Për miratimin e parimeve dhe karakteristikave të përgjithshme teknike për krijimin, funksionimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe auditimin e Platformës Elektronike të Regjistrimit (PER).